



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 01/11

Prishtinë, më 15.03.2011, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj, Muhamet Mustafa dhe Duda Balje.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe Alexander Beetz, Juergen Schatz, Ramadan Islami, Teki Shala dhe Njomza Ilazi nga GIZ si dhe monitorues nga KDI dhe USAID.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli dhe Aurora Ademi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Konstituimi i komisionit**
- 2. Të ndryshme.**

1. Konstituimi i komisionit

Kryesuesja, përshëndeti të pranishmit duke ju uruar zgjedhjen e deputetëve të Parlamentit të Republikës së Kosovës si dhe anëtarë të komisionit për Buxhet dhe Financa. Theksoi që ky komision është i përhershëm dhe njëri ndër komisionet kryesore që ka një veprimtari shumë të rëndësishme për punën e Kuvendit të Kosovës. Kryesuesja premtoi që do të jetë bashkëpunuese dhe do të përpiqet që ky komision të mos shndërrohet në pozitë dhe opozitë, por të merret konkretisht me punët dhe aktivitetet që ua ngarkon ky komision. Detyrat e këtij komisioni janë të shumta, por ajo më kryesorja është shqyrtimi i projektbuxhetit dhe shqyrtimi i rivlerësimit të projektbuxhetit, sepse Ligji për Buxhetin është njëri nga ligjet më kryesore që aprovohet në Kuvendin e Kosovës. Në Komisionin për Buxhet dhe Financa kalojnë të gjitha projektligjet për të shqyrtuar koston financiare, shqyrtohen të gjitha raportet periodike dhe vjetore të Buxhetit të Kosovës, të Agjencive dhe Institucioneve të

pavarura që janë përgjegjëse ndaj Kuvendit. Kryesuesja përshëndeti dhe falënderoj organizatat ndërkombëtare që kanë ndihmuar dhe monitoruar Kuvendin, si NDI, OSBE, UNDP, USAID, e në veçanti GIZ e cila me një projekt afatgjatë ka ndihmuar dhe vazhdon të ndihmojë Komisionin në kryerjen e detyrave të tija. Ajo theksoi se do të punohet edhe rreth hartimit të një Plani Vjetor të komisionit të cilit do t'i përshtaten, Strategjisë Legjislative, të cilën po e Qeverisë të cilën po e presin.

Kryesuesja hapi diskutimin duke i ftuar anëtarët nëse kanë diçka të flasin rreth punës dhe funksionimit të komisionit ose ndonjë kërkesë eventuale.

Sali Asllanaj, përshëndeti dhe uroi të pranishmit. Kërkoi që ky komision të punojë më shumë me organe jashtë Kuvendit dhe me ekspertë të ndryshëm të fushës së ekonomisë për t'ju ndihmuar atyre që janë më të ri në këtë komision. Gjithashtu theksoi që do të ishte më mirë të organizohen tryeza të rumbullakëta për diskutim të Buxhetit.

Kryesuesja, tha që në kuadër të komisionit edhe gjatë vitit të kaluar është paraparë buxhet, që do të na ndihmojnë për të angazhuar ndonjë ekspert në fushën e caktuar.

Naser Osmani, përshëndeti dhe uroi kryetaren për postin e saj. Theksoi që duhet të organizohemi mirë lidhur me atë që ka të bëjë me interesat e përgjithshme të funksionimit të shtetit, sepse nga përvoja kemi kuptuar që ndihma më e madhe, mbetet interesimi personal dhe angazhimi i njerëzve që do të na ndihmojnë në kryerjen e punëve të mëtutjeshme. Si çështje më të veçantë në këtë fazë mbetet Buxheti, dhe në bazë të informatave që ka siguruar, shqyrtimi i parë i buxhetit do të bëhet 25 mars, dhe kjo kufizon kohën për të shqyrtuar dhe amendamentuar buxhetin në Komision, për të organizuar dëgjime buxhetore në komision. Ai theksoi se në fund të këtij muaji mund të vijmë në krizë institucionale buxhetore për arsye se vendimi i Kuvendit për vazhdimin e buxhetit skadon, ndërsa ne nuk jemi në gjendje ta kalojmë buxhetin brenda dy ditëve, kjo do të na çojë në një situatë të pakëndshme edhe në mes të raporteve tona. Ai gjithashtu theksoi se nuk do të ishte mirë t'i ftojme ministrinë për arsye se secili ministër ka qenë në mbledhjen e Qeverisë dhe ka mundur të ndikojë në propozim buxhetin e tyre Buxhetit. Ndërsa do ishte jonormale nëse Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk do të merret me buxhetin e institucioneve të pavarura, qofshin ato zyre, agjenci apo shërbime të ndryshme që janë pjesë e Kuvendit, si dhe me buxhetin e Kuvendit.

Xhevdet Neziraj, pasi përshëndeti dhe urojë anëtarët e Komisionit, theksoi që do të bëjmë përpjekje që bashkarisht të punojmë, që këtë komision ta bëjnë të veçantë nga të tjerët për shkak të kompetencave që i ka. Jemi në fazë ku duhet përshpejtohen procedurat në shqyrtimin dhe miratimin e buxhetit, të përpiqemi që ti trajtojmë buxhetin e agjencive të pavarura, me të cilat kemi pasur probleme edhe në të kaluarën në miratimin e buxhetit të tyre, por duhet të përpiqemi maksimalisht.

Muhamet Mustafa, përshëndeti të gjithë dhe shprehu kënaqësinë që është pjesë e një angazhimi për një çështje kaq të rëndësishme. Ai theksoi që ka telashe me buxhetin, duke pasur parasysh që nevojat janë të mëdha, ndërsa mundësitë nuk përputhen me ato nevoja, prandaj duhet të gjendet një optimum që me këto mjete të cilat i kemi në dispozicion të arrijmë maksimumin e mirëqenies sociale dhe mos të vijmë në një situatë që të kalohet formalisht. Ai sugjeroi kryetaren dhe zëvendëskryetarët që në bashkëpunim me Kryetarin e Kuvendit të bëjnë një agjendë e cila do të kishte krijuar hapësirën e nevojshme për një trajtim cilësor të Buxhetit. Nëse paraqitet nevoja të mbahen edhe mbledhje të mbyllura, në mënyrë që anëtarët e komisionit t'i dinë ku janë problemet, dhe të ndihmojnë në trajtimin e atyre problemeve si komision. Përkrahu propozimet për të pasur asistencë në analizën e buxhetit, ku do të përgatiteshin disa tabela, struktura dhe dinamika të buxhetit për anëtarët e komisionit për të parë pjesëmarrjen sipas fushave.

Kryesuesja, njoftoi se rregulli për të dalë buxheti për miratim në parim në Kuvend është dhjetë ditë pune pasi të dorëzohet në Kuvend dhe sipas llogaritjeve të saj i bien më datën 24 mars, mirëpo është caktuar data 25 mars. Ajo tha që është interesuar tek stafi se a ka sjellë dikush kërkesa buxhetore për të ndërhy në buxhetin e përgjithshëm dhe ai që ka sjelle është vetëm Komisioni i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil. Ajo, po ashtu theksoi që ka edhe kërkesa nga mandati i kaluar, prej të cilave disa janë të protokoluara e disa jo, dhe ajo është konsultuar me personat përgjegjës në Kuvend se a janë objekt i shqyrtimit ato kërkesa që kanë ardhë në një mandat tjetër, sepse të gjitha ligjet që janë të pashqyrtuara në Kuvend në mandatin tjetër, i kthehen Qeverisë. Ajo propozoi që shqyrtimi në parim i projektbuxhetit nga Komisioni të bëhet të premten më 18 mars në ora 11 ku do të jetë prezent edhe ministri, pasi që ashtu parashihet me Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Naser Osmani, tha që sa do të ishte e arsyeshme që të mbahet mbledhja të premten , për shkak që ata nuk janë të obliguar që para leximit të parë të takohen, pasi që secili prej tyre i kanë vlerësimet dhe opinionet e tyre të cilat i bëjnë publike në lexim të parë. Ai sugjeroi kryetaren që ta bëjë një agjendë për të definuar se kë do ta ftojnë në dëgjim buxhetor, Në mes të tjerash ai theksoi që si komision janë të obliguar që ta trajtojnë edhe buxhetin e Kuvendit, kështu që do të kishte qenë mirë sipas tij që katër ose pesë agjencione të pavarura dhe buxhetin e Kuvendit ta trajtojnë në një takim. Si dhe ndonjë kërkesë të Ministrisë që ka bërë ndonjë lëshim teknik dhe që është e domosdoshme ndërhyrja në buxhet. Ai, po ashtu kërkoi që nëse ka ndonjë kërkesë nga mandati i kaluar t’ju ipet mundësia që t’i shohin dhe t’i trajtojnë ato.

Kryesuesja, u sqaroi anëtarëve të komisionit që në Rregullores së Kuvendit sipas **nenit 56**: Para shqyrtimit të parë të projektligjit në mbledhje plenare, komisioni funksional-raportues, i ngarkuar nga Kryesia e Kuvendit e shqyrton projektligjin në parim. Komisioni i paraqet Kuvendit raport me rekomandime për miratim ose për mosmiratim të projektligjit në parim. Pra, ajo theksoi që ata si komision e shqyrtojnë në parim, pastaj e dërgojnë në seancë plenare që kalon në shqyrtim të parë, mirëpo ajo tha që gjatë kësaj kohe ata mund të punojnë me kërkesa të agjencioneve.

Kryesuesja ftoi Alexander Beetz përfaqësues nga GIZ që të marrë fjalën për të njoftuar për projektin në përkrahje të komisionit.

Alexander Beetz, falënderoi të pranishmit dhe urojë për zgjedhjen e tyre si anëtar të Komisionit. Më pas njoftoi të pranishmit për historinë e nisjes së projektit afatgjatë të financuar nga Qeveria Gjermane dhe implementuar nga GIZ, për mbështetje në fuqizimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Ai shprehu gatishmërinë për të mbështetur komisionin në të gjitha mënyrat dhe se punët do të koordinohen duke vlerësuar nevojat që mund ti kenë anëtarët e komisionit.

2. Të ndryshme

Hykmete Bajrami, kërkoi nga kryetarja që edhe njëherë të saktësohet dita dhe ora e mbajtjes së mbledhjes së ardhshme dhe të caktohen detyrat e tyre. Theksoi që secili e ka dyshimin lidhur me atë se ajo çka është shkruar në letër është e realizueshme pasi që Qeveria deri tash nuk ka dhënë asnjë sqarim se cilat janë raportet me FMN-në duke pasur parasysh që buxheti bazohet diku rreth 200 milionë të hyra nga financimi prej këtyre institucioneve, për këtë ajo sugjeroi që të ftohet Ministri për të dhënë sqarime më konkrete lidhur me këtë çështje. Ajo theksoi që partia së cilës i takon do të dalin me qëndrimet e tyre, jo vetëm për të qenë kundër, por për arsyen se kanë përgjegjësi ndaj votuesve të tyre.

Kryesuesja, e arsyetoi kërkesën e Hykmetes pasi që nuk është mbajtur ndonjë trajnim për deputetët e ri, mirëpo në Rregulloren e Kuvendit shënohen detyrat e komisionit dhe mënyra e shqyrtimit të projektligjeve nga ana e komisioneve. Propozojë që si ditë orientuese e takimeve të Komisionit, të jetë dita e martë ose e mërkurë, prej orës 11:00. Ndërkaq në fazën e buxhetit do të mbahen takime më të shpeshta.

Mbledhja e radhës u caktua të premten më 18.03.2011, në ora 11:00

Mbledhja përfundoi në orën 13:50

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesja e Komisionit

Safete HADERGJONAJ